



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ~~3864~~/prot. 1

Himarë, më 29.05 . 2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes e radhës të Këshillit Bashkiak Himarë.

Të nderuar këshilltarë,

Ju njoftojmë se ditën e enjte më datë 04.06.2026, ora 10:30 në sallën “Neço Muko” Himarë do të zhvillohet mbledhja për muajin maj, e Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të pikës 4, të nenit 53, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Mbledhja do të ketë këtë rend dite.

Miratimi i rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për dhënien në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 1.74 Ha, në ekonominë pyjore “Mali i Pilurit Çikë”, ngastra nr. 69, zona kadastrale 3813, në favor të z. Bardhosh Çeloleskaj”;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e niveleve kufi të zhurmës dhe orareve të lejuara në zonat e ushtrimit të aktiviteteve turistike dhe argëtuese në qytetin Himarë”;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e planit të masave për parandalimin e situatave të mundshme nga zjarret e krijuara si pasojë temperatuave të larta”;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e planit të veprimit mbi radhën e punës dhe procedurave që do të ndiqen nga drejtoria e mbrojtjes së territorit dhe emergjencave civile në Bashkinë Himarë”;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për dhënien e miratimin për fillimin e procedurave, për dhënien në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar të një sipërfaqe prej 1755 m², të pasurisë të llojit kullotë me nr. 480, në zonën kadastrale 2311, Kudhës Himarë, në pronësi të Bashkisë Himarë, në favor të Agron Velço”;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e dhënies së dëmshpërblimit financiar për dëmtimin e banesës së z. Jorgo Neranxi, në Himarë nga fatkeqësitë natyrore”;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e dhënies së dëmshpërblimit financiar për dëmtimin e stanit e z. Lame Bojkoj, në fshatin Tërbaç nga fatkeqësitë natyrore”;

8. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e dhënies së dëmshpërblimit financiar për dëmtimin nga zjarri të banesës të znj. Olimbi Micaj, në fshatin Vranisht”;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e ndihmës ekonomike për periudhën 1-30 prill 2026, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike”;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 39, datë 20.12.2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë, si institucion në varësi të Bashkisë Himarë”;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 15, datë 28.04.2026, “Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës ”;
12. Të ndryshme.

Sekretari

Zaho Dedi

